



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2021:084092

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05419588

P.nr.160/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJE-DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të akuzuarit: T (H) B, nga fshati I, K. D, ka kryer vepër penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.780/2021, të datës 26.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësore me datë 05.02.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të akuzuarit T. B dhe mbrojtësi i tij av.I.O, përfaqësuesi i të dëmtuarës K, A. M, dhe dëshmitarët e K., S.R, B G dhe E. H, datën 07.02.2024, shpalli kurse me datën 27.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj:

Të pandehurit T. B, i lindur me, në D, tani me banim në fshatin I. K. , i biri i H, dhe nënës Gj, i martuar, baba i 3 fëmijëve, pronar i restorantit M, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me parë e gjerë me dt....., në lokalitë e tij ..., restorant “M”, në Rr. “S. Ç”, pa numër, në D, në mënyra të tjera përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar dhe atë të kompanisë K, në atë mënyrë që i pandehuri në adresën e lartshënuar në njehsorin elektrik me numër konstatohet se i njëjti ka instaluar një kabull prej 5x2,5 mm², me prizë-trefazor dhe atë jashtë pikës matëse duke pamundësuar regjistrimin dhe

faturimin e energjisë elektrike, me ç'rast konstatohet se kompanisë K i shkakton dëmin në vlerë prej 2,330.86.

-me çka ka kryer veprën penale, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 1 të KPRK-së,

Andaj Gjykata, në kuptim të nenit 2, 4,7,8,9,10,21,38,39,40,42,46,47,48,49,50, si dhe neni 314 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I. Të akuzuarit T. B, i shqiptohet dënimi më burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

Në të kundërtën, nëse i akuzuari brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen veprë tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 par.2 dhe 3 të LPRK-së, do ta revokoj dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të shqiptohet dënimi unik për veprën penale të kryer më parë dhe veprën penale të re.

II.OBLIGOHET i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj në shumë prej njëzetë (20) euro, dhe në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Pala e dëmtuar K, - D, në P, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritë aktakuzën PP/II.nr.780/21 të datës 26.04.2021, kundër të akuzuarit T.B, nga fshati I. K. D, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.09.2023, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala, i pandehuri T. B, ku pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, pastaj të akuzuarin gjykata e ka njoftuar me të drejtat për kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhje të aktakuzës, konform nenit 249 dhe 250 të KPPRK-së, ku i pandehuri B, ka deklaruar se heqë dorë nga paraqitja e kundërshtimit dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe nga shqyrtimi i dytë gjyqësor duke kërkuar që të kalohet direkt në shqyrtimin gjyqësor.

Duke vepruar sipas kësaj aktakuze Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 11.10.2023, 24.01.2024 dhe me datën 05.02.2024, në praninë e prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, i pandehuri T. B, mbrojtësit të pandehurit av. I.O, përfaqësuesi i K A. , dhe dëshmitarëve B. G, S. R dhe E. H, në këtë çështje penale është bërë dëgjimi i dëshmitarëve, administrimi i provave material, mbrojtja nga i akuzuari si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse gjatë shqyrtimit gjyqësorë si dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar: edhe gjatë seancës të këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetuan në tërësi pretendimet e akuzës se këtu i pandehuri T.B, ka kryer veprën penale nga neni 314 par 1 të KPRK-së siç është përshkruar në akuzë. Dëshmitarët B. G, dhe E. H, punëtor të K, të dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 24.01.2024, edhe një herë para gjykatës kanë deklaruar se gjatë kontrollit në lokalin e këtu të pandehurit “M”, në Rr. “S. Ç”, në D, me datën, është hasur se i njëjti kishte instaluar një kabllo prej 5x2.5m, me prizëm tre fazor dhe atë jashtë pikës matëse duke pamundësuar regjistrimin dhe faturimin e energjisë elektrike të shfrytëzuar me ç’rast të dëmtuarës K, si pasojë e veprimeve të kundërligjshme i ka shkaktuar dëme materiale në shumën prej 2,330.86 euro, për çka të njëjtën ditë kur është kry kontrolli lidhur me të gjeturat e tyre kanë përpiluar procesverbalin i cili është administruar si provë në shqyrtimin gjyqësor edhe pse lidhur me këtë çështje fillimisht aktakuza për keqpërdorim të energjisë elektrike është ngrit ndaj Sh. D, i pandehuri me dëshminë edhe në cilësi të dëshmitarit pranë gjykatës ka deklaruar se njëhensori elektrik i vendosur në restorantin “M” është në lokalin e tij që e ka blerë në vitin 2014, dhe është shfrytëzues deri më tani i njëhensorit edhe pse i njëjti figuron në emër të Sh. D. Me dëshminë e tij në gjykatë i pandehuri nuk e mohoj faktin se njëhensori elektrik është në emër të Sh. D, edhe pse

vetë i pandehuri e shfrytëzon energjinë elektrike për nevoja të restorantit, gjithashtu provat materiale që i janë bashkangjitur aktakuzës si procesverbali i datës me numër fotografitë nga vendi i ngjarjes, profaturat mbi demin e shkaktuar me numër, të datës vërtetojnë në plotni fajësinë për veprën penale që ngarkohet në akuzë, andaj të pandehurin T. B, edhe në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor e konsideroj si fajtor për veprën penale 314 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit po ashtu i propozoj gjykatës që më rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merren parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit ti caktohet ai lloj dhe lartësi e dënimit i cili do të jetë në proporcion me peshën e veprën penale dhe i cili dënim do të ndikojë që mos kryej vepra të tjera penale.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Isa Osdautaj, në fjalën përfundimtare deklaroj se nga administrimi i provave materiale dhe atyre formale në këtë çështje penale nuk u vërtetua dyshimi bazuar se i pandehuri T. B, ka kryer veprën penale nga neni 314 par 1 të KPRK-së, përshkruar në aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, me shenjën PP/II.nr.780/2021 e datës 26.04.2021, për faktin se nga leximi i provave e posaçërisht i procesverbalit të datë 29.05.2018 me numër 0724146, i përpiluar nga punëtorët e K, figuron se njehsori elektrik në atë periudhë por edhe tani evidentohet në emër të Sh. D, për faktin se i njëjti edhe sot nuk i përmbush obligimet ndaj K. I pandehuri T. B, orën që e ka bërë regjistrimin e shpenzimit të energjisë elektrike e ka trashëguar nga tre shfrytëzuesit paraprak të cilët edhe sot kanë obligime ndaj K dhe K, dhe ata janë Sh. D, E. D dhe Sh. H. Punëtorët e K, këtë orë e kanë pasur në dispozicion në çdo kohë dhe në çdo moment që ta verifikojnë mirëpo në procesverbalin dhe obligimet e tyre ndaj K, thjeshtë na japin me kuptu se punëtorët e K, kanë qenë në lidhmëni me shfrytëzuesit paraprak ashtu që tërë parregullsitë që i kanë krijuar paraprakisht me njehsorin elektrik obligimet ndaj K janë munduar ti bartin tek pronari i lokalit tani T. B, i cili për shkak të obligimeve të tyre edhe sot nuk mund ta regjistrojë lokalin, orën elektrike dhe obligime të tjera në emër të tij. Më pas mbrojtësi ka shtuar se i ceka të gjitha këto fakte se mungon elementi i veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga i pandehuri T. B, e thënë këtë për shkak se ndaj shfrytëzuesit paraprak është ngritur aktakuzë dhe është zhvilluar procedura penale për keqpërdorimin e shërbimeve të rrymës elektrike këtë më së miri e vërteton se tani i pandehuri T. B, nga momenti i marrjes së lokalit drejtpërdrejtë e ushtron veprimtarin e tij hotileri në restorantin “M”, nuk e ka asnjë obligim ndaj të dëmtuarës K dhe atëherë shtrohet pyetja logjike a ka arsye të bëjë vjedhje të shërbimeve përmes kabllit të profilit 5x2.5 mm gjeja i lidhur jashtë ore që nuk e bënë regjistrimin e shpenzimit të rrymës elektrike. E dëmtuara ka mekanizëm që saktë mund ta dijë me orë dhe ditë se kur është vendosur kablllo i

tillë, por nuk është marrë me një punë të tillë vetëm ka hartuar procesverbalin pa prezencën e pronarit të lokalit që ushtron veprimtarin pa ndërpre, nga të gjitha këto të lartcekura përfundimisht deklarohem lidhur me veprën penale i pandehuri T. B, është i pa përgjegjshëm në rastin konkret sepse tërë veprimtaria është regjistruar në emër të Sh. D, andaj gjykatës i propozojmë që të pandehurin T .B ta shpall të pafajshëm me aktgjykim lirues.

Gjykata në bazë të nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm në këtë çështje penale, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë, vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes se tij. Me ndërgjegje dhe në bazë të ligjit u vlerësua çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë, u vërtetua kjo gjendje faktike nga provat e administruara si me poshtë.

Provat e administruara

Për të vërtetuar këtë gjendje faktike në këtë çështje penale gjykata në shqyrtimin gjyqësor, ka bërë administrimin e provave të propozuara nga palët:

Provat personale, dhe atë dëgjimin e dëshmitarëve:

- B. G, E.H, dhe S. R.

Provat materiale siç janë:

- Procesverbali i K, me numër i datës
- Fatura e K, me nr. e datës, dhe
- Është bërë shqimi i foto-dokumentacionit të cilat gjenden ne shkresa te lëndës.

Faktet jo kontestuese dhe faktet kontestuese

Nuk ka qenë kontestuese fakti se i akuzuari ditën kritike kur është bërë kontrolla nga punëtorët e K, ka qenë duke e shfrytëzuar lokalin i cili është objekt në këtë çështje penale, e cila rrethanë u vërtetua nga dëgjimi i dëshmitarëve, dhe po ashtu nuk është mohuar as nga i akuzuari.

Nuk ka qenë kontestuese fakti se një degëzim i kabllit 5x2.5 mm, përmes prizës-trefazor ka qenë e kyçur jashtë njehsorit në lokalin e të akuzuarit T. B.

Kontestuese ka qenë fakti nëse i akuzuari e ka vendos kabllon jashtë njehsorit elektrik për keqpërdorim të rrymës, apo e njëjta është vendosur nga shfrytëzuesit paraprak të lokalit.

Provat personale

Dëshmitari S. R, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: është punëtor ne kompaninë e K distrikti në P, që identifikohet me numër, me titull ekspert për monitorim dhe kontrollim të humbjeve në teren, me datën ..., gjatë kontrollit tek lokali 3 tek restorant , kanë konstatuar tek konsumatori i cekur në procesverbal se kanë shkuar për kontroll rutinë, kanë ndalur energjinë elektrike përmes njehsorit dhe në furnizim të energjisë ka mbetur vetëm aparati i kafes, që dmth ka shfrytëzuar jashtë pikës matëse energji elektrike. Ekipa ka qenë në përbërje prej 4 veta kemi përpiluar procesverbal dhe në lokal ka qenë dikush dhe e ka nënshkruar procesin, pasi e kemi konstatuar lidhjen direkte jashtë pikës matëse e kemi eliminuar atë dhe e kemi kthyer në gjendje të rregullt.

Dëshmitari B. G, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është zyrtar i K, ne P, që identifikohet me numër, duke shtuar se në atë kohë ka qenë ekspert për zvogëlimin e humbjeve komerciale në nivel të Kosovës. Me datën, gjatë kontrolles janë prezantuar, aty ka qenë prezent H. B. Të cilin e kanë njoftuar se duhet bërë kontrollimin e njehsorit elektrik edhe instalimin, gjatë kontrolles e kemi ndal njehsorin elektrik dhe kemi vërejtur se aparati i kafes ka qenë nën tension ka pas rrymë, nën shank ka qenë një kabull e degëzuar nëpërmes saj është furnizuar aparati i kafes dhe jashtë njehsorit elektrik, ku personalisht e ka eliminuar atë kabull dhe është formuluar procesverbali, pajisje të tjera nuk ka pas të lidhura jashtë njehsorit. Në fund dëshmitari B. G, ka deklaruar se nuk është e vërtetë se i kanë thënë punëtoreve se është vetëm vërejtje sepse askujt nuk i thonë se është vërejtje kur përpilohet procesverbali, përkundrazi i njoftojnë se është kabull jashtë rregullave.

Dëshmitari E. H, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se është zyrtar i K. ne P, që identifikohet me numër, ka punuar në departamentin e kontrollimit të humbjeve të energjisë elektrike, zakonisht tek analistet i analizojnë trafot që kanë humbje më tepër dhe i nxjerrin numrat e konsumatorëve. Dëshmitari ka deklarua se me datën, kanë qenë ekipe i kontrolles në përbërje prej 5 vetave, kanë hy në lokal janë prezantuar si zyrtar të K, personi që ka qenë

përgjegjës në lokal është njoftuar se do ta kontrollojnë orën e rrymës si dhe instalimin përcjellës, iu ka dhënë leje të njëjtit i kanë treguar se duhet të ndalet rryma për të verifikuar se a ka keqpërdorim të rrymës në bashkëpunim iu ka thënë po ndalne rrymën, e kanë ndal njehsorin që bënë matjen e energjisë së konsumatorit dhe gjatë kontrolles kanë hasur në një kabull nga e cila ka qenë duke u keqpërdorur energjia elektrike, njehsori ka qenë i ndalur, aparati i kafes ka qenë funksional jashtë njehsorit elektrik, i kanë treguar përgjegjësit se është duke u keqpërdorur energjia, e kanë eliminuar atë kabull aty si prizëm që ka qenë, dhe më pas kanë përpiluar procesverbal në lokal tek konsumatori dhe kanë shkuar vetëm pajisjet që kanë qenë duke u keqpërdor.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari T. B, në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se restorantin e ka blerë që 10 vite, të cilin 2 vite e ka pas me qira E. D, dhe 7 muaj e ka pas Sh. H, e më pas e ka hap vetë restorantin dhe nuk ka bërë ndryshim asgjë në të përveç inventarit. Kur e ka marr restorantin e ka marr me 14,500 euro borxh , ku 10.000 euro kanë qenë të K, ndërsa 4.500 te K, të cilat i ka paguar vet kurse 10.000 euro te K, janë hala ashtu siç kanë qenë. Tutje i pandehuri ka deklaruar se ora e cila ka qenë e vendosur para se ta merrte lokalin nuk ka ndryshuar dhe se nuk ka ndryshuar asnjë kabull prej qe e ka marr lokalin gjendja është e njëjtë. Më pas i pandehuri ka shtuar se kjo ka qenë hera e parë e kontrolles, punëtoret e K, në çdo kanë mundur të kenë qasje, nuk i kujtohet se në cilin vit e ka pasur posedim lokalin Sh. D, dhe nuk i kujtohet çfarë ka deklaruar kur i pandehur ka qenë Sh. D, ndërsa pasi që i është lexuar një pjesë e asaj deklarate i pandehuri ka deklarua se po është e vërtetë ajo pjesë e deklaratës që e kam dhënë. I pandehuri në fund ka shtuar se 4500 euro i ka paguar ndërsa 10.000 euro te K, jo, pagesën e atyre të hollave e ka bërë pasi që ka pas premtim se nëse paguan këtë borxh do ta qesë orën në emrin e tij, ku sot e asaj dite nuk ka mundur ta qes në emër të tij për shkak se K, nuk i janë paguar 10.000 euro.

Vlerësimet e gjykatës

Nga procesverbali me numër i datës ..., i përpiluar punëtoret e autorizuar të K, në P, gjykata ka vërtetuar faktin se gjatë kontrolles në njehsorin elektrik me numër, në lokalin e të pandehurit është hasur në një kabull prej 5x2,5 mm², me prizë-trefazor të instaluar dhe atë jashtë pikës matëse duke pamundësuar regjistrimin dhe faturimin e energjisë elektrike ku e kanë

fotografuar për dëshmi dhe e kanë eliminuar parregullsinë dhe është proceduar sipas rregullores së K.

Nga fatura e datës, e lëshuar nga K, për përkthimin e humbjeve, rezulton se është përcaktuar borxhi për rikthimin e humbjeve në shumën prej 2,330.86 €.

Nga foto dokumentacioni që i është bashkangjitur shkresave të lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se gjatë kontrolles, personat e autorizuar nga K, ditën kritike kishin bërë fotografimin e kabllit të degëzuar 5x2.5 mm prizë-trefazore me anë të cilës është bërë keqpërdorimi i energjisë elektrike.

Gjykata pas analizimit me shumë kujdes të të gjitha provave një nga një e në lidhmëri njëra me tjetrën të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se duhet ti falet besimi i plotë, deklaratave të dëshmitarëve B.G, E. H dhe S. R, meqenëse deklaratat e tyre përputhen njëra me tjetrën dhe kanë mbështetje edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat është vërtetuar fakti se i akuzuari, është pronar i lokalit i cili është objekt në këtë çështje dhe të njëjtin e shfrytëzon, dhe se në ditën kritike kur është kontrolluar ka rezultuar se një degëzim të kabllit 5x2.5mm përmes prizës trefazore ka qenë e instaluar dhe atë jashtë pikës matëse duke pamundësuar regjistrimin dhe faturimin e energjisë elektrike dhe si pasojë të dëmtuarës K, i ka shkaktuar dëm material, në shumën prej 2,330.86 €.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit T. B, të dhëna në këtë çështje penale mirëpo gjykata ka vlerësuar se pretendimet e tij nuk gjejnë mbështetje në asnjë provë materiale dhe personale, por këto pretendime kanë për qëllim që i njëjti të i ik përgjegjësisë penale për veprën penale që i vihet në barrë, pasi që vet i pandehuri i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor kur Sh. D, akuzohej për keqpërdorim të rrymës elektrike, kishte deklaruar se në vitin 2014 e kishte blerë këtë lokal dhe që nga ajo kohë si pronarë i këtij lokali e shfrytëzon njehsorin elektrik me numër, por që ende figuron në emër të Sh.D, dhe pas kësaj deklarate prokurori është tërhequr nga aktakuza ndaj të pandehurit D, me njoftim se aktakuzën do ta ngris për të pandehurin T. B, si përgjegjës për kryerjen e kësaj vepre penale.

Po ashtu Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit av.Isa Osdautaj të dhëna me fjalë përfundimtare, mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë

provë materiale dhe personale, por kishin për qëllim që ta minimizonin përgjegjësinë e penale të mbrojturit të tij këtu të pandehurit T. B.

Elementet e veprës penale

Në paragrafin 1 të nenit 314 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale vjedhja e shërbimeve e kryen: “*Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet*”. Në rastin konkret plotësohen këto elemente të veprës penale, meqenëse nga provat e shtjelluara u vërtetua se, i pandehuri në mënyrë të pa autorizuar, është kyçur në rrjet elektrik jashtë njehsorit elektrik, ku me një degëzim të kabllit 5x2.5mm përmes prizës trefazore e cila ka qenë e instaluar dhe atë jashtë pikës matëse duke pamundësuar regjistrimin dhe faturimin e energjisë, duke anashkaluar kështu njehsorin elektrik-pikën matëse me ç ‘rast ka penguar kështu matjen e shpenzimeve të KW, të shpenzuar i cili në mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në bazë të provave të administruara u vërtetua në mënyrë të pakontestueshme se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale: vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 1 të KPRK-së, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë paraqitur rrethana të cilat do të përjashtojnë apo zvogëlojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit kështu që është penalisht përgjegjës.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit , vlersoi të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që të akuzuarit T.B, ku si rrethanë renduese gjykata ka vlersuar dashjen direkte të akuzuarit të kjo vepër penale, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjëshmërinë e plotë,

kontributin esencjal të tij në këtë vepër penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka vlerësuar sjelljen e tij gjatë procedurës penale. Gjykata nga rrethanat e lartcekura, në rastin konkret ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të akuzuarit, të cilët do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 452 par.

1

dhe nenit 449 par. 2 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është

marrë, konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Udhëzimi i palëve të dëmtuara në kontest të rregullt civil është i bazuar në dispozitat e nenit 462

par 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata e përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

P.nr.160/21 me datë 06.03.2024

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.